



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

P.nr.644/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, me gjyqtaren Violeta Husaj Rugova, me sekretaren juridike Arjeta Kelmendi në çështjen penale kundër të akuzuarit M K nga Peja, për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Përgjithshme, PP/II.nr.1257/2017 të dt.12.06.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencë të Prokurores së shtetit Lumturije Hoxha, të akuzuarit M K, përfaqësuesi i KEDS-it, B Sh me dt.25.10.2017 mori dhe të njëjtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

M K, i biri i Sh dhe nënës Gj e gjinisë R, i lindur me dt., në Pejë, ku edhe banon, rruga “ ”,, ka të kryer shkollën, i gjendjes së ekonomike, më nr.personal dhe me nr. tel., shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR
për shkak se:

Me dt.28.10.2015, fsh. “.....” K-Pejë, në shtëpinë e të pandehurit i njëjti është lidhur në mënyrë të pa autorizuar në përçues të rrymës elektrike në atë mënyrë që gjatë kontrollimit të komisionit të autorizuar të “KEDS-it”, është konstatuar se të njëjtit kanë hasur në njehsorë pa pllombë distributive dhe gjatë kontrollit të mëtutjeshëm është hasur edhe një kablo 2x2.5 mm., jashtë njehsorit ashtu që në mënyrë të pa autorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike me ç’rastë të dëmtuarës i ka shkaktuar dëme materiale në shumë prej 128.33 Euro.

-Me çka ka kryer veprë penale, lidhej e paautorizuar me shërbime nga neni 321 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin, 7, 41, 42, 49, 50, 51, 52 të KPRK-së, dhe nenit 321 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit M K, i përcaktohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 3 muaj, si dënim me gjobë në shumë prej 150 euro mirëpo këto dënime nuk do të ekzekutohen në rast se i akuzuari brenda periudhës 1(njëvjeçare) nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari që palës së dëmtuar KEDS-it ti paguaj dëmin në shumë prej 128.33 euro në afat prej 3(tre) muaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 15 euro në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Përgjithshme, ka ngrit aktakuzë PP/II.nr.1275/17 të dt. 12.06.2017, kundër të akuzuarit M. K nga Peja, për shkak të veprës penale lidhje e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mos pranimin e fajësisë, i akuzuari M.K, pasi që i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimin të fajësisë të cilat ju janë shpjeguar nga ana e gjykatës, deklarojë se e pranojnë fajësinë për veprën që i vihet në barrë.

Prokurorja ka deklaruar: se pajtohet me pranimin e fajësisë pasi që i njëjtit është i vullnetshëm dhe është në përputhje me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Në vijim gjykata duke e shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit, pasi që i njëjti i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimin të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave, por gjykata ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjykata e shpalli fajtor të akuzuarin bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e tij dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës siç janë: procesverbali mbi gjendjen e njehsorit me numër 0499044 i datës 28.10.2015, fatura e KEDS-it me numër të References.20110 të datës 30.10.2015, si dhe të shikohen foto dokumentacion dhe shkresat e tjera të lëndës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 73 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit dhe nga rrethanat lehtësuese gjeti se: i akuzuari, e ka pranuar fajësinë, pat sjellje korrekte para gjykatës, premtojë se, nuk do të përsëritë veprime të tilla. Ndërkaq nga rrethanat rënduese për të akuzuarin gjykata nuk gjeti asgjë.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur

se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprës penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KPK-së.

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së, në paguarjen paushallit gjyqësorë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365, të KPPRK-së.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM P.nr. 644/17

Procesmbajtësja
Arjeta Kelmendi

G J Y Q T A R J A
Violeta Husaj Rugova

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.